

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-722/022	Data: Datum: 03.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), nenin 10 paragrafi 4 nenin 11 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.13/2019), nenin 21 dhe 26 të Ligjit 05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 31 të Statutit të Komunës së Istogut Nr.62/2010 i datës 30.11.2010, Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike shqyrtoj kërkesën 01-034-42307 të datës 03.10.2022 të parashtruar nga Selvije Rexhaj nga fsh. Cërrocë, për qasje në dokumente publike, i propozon verbalishtë Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike.

1. MIRATOHET: kërkesa 01-034-42307 të datës 03.10.2022 të parashtruar nga Selvije Rexhaj, si e bazuar për qasje në dokumente publike, me qëllim të sigurimit të një kopje të lejes ndërtimore objektit i ndërtuar në vitin 2003 në emër të ish bashkëshortit Xhevdet Rexhaj MO W dhe i lejohet qasja e plotë e të dhënave të lejes ndërtimore, si me poshtë:

- 1.1.** Kopja e lejes ndërtimore në emër të Xhevdet Rexhaj.
- 2.** Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Jeta Balaj-Imeraj-Zyrtare për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.
- 3.** Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Selvije Rexhaj, ka parashtruar kërkesë 01-034-42307 të datës 03.10.2022, për qasje në dokumente publike, me qëllim të sigurimit të një kopje të lejes ndërtimore të datës 02/10/2003 objektit i ndërtuar në vitin 2003 dhe i lejohet qasja e plotë e të dhënave të lejes ndërtimore.

Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike ka shqyrtuar kërkesën si të bazuar dhe pas analizimit dhe vlerësimit të kërkesës i propozoj verbalishtë Kryetarit të vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryetari e shqyrtoj propozimin verbal të Zyrtares për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe e miraton lejimin e qasjes në dokumente publike si në pikën 1 të këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 ditëve nga data e pranimit të tij.

Vendimi i dërgohet:

- Selvije Rexhaj,
- Jeta Balaj-Imeraj-Zyrtare për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-723/022	Data: Datum: 03.10.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 30.09.2022, për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin: “Riparimi i bus stacioneve” më numër të jashtëm prokurimi 633-022-4432-5-3-6/C571 dhe nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për verifikimin e punëve për projektin “Riparimi i bus stacioneve”, më numër të jashtëm prokurimi 633-022-4432-5-3-6/C571, të cilin projekt e ka realizuar operatori “**Lani-AL**” SH.P.K dhe në komision caktohen:

- 1.1. Naser Gjoci,** Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Tahir Maksutaj,** Zyrtar për Monitorimin e Kamerave, anëtar dhe
- 1.3. Arta Fetahu,** Zyrtare për Planifikim dhe Zhvillim, anëtare.

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj kompaninë mbikëqyrëse “PMN” SH.P.K; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e pranimit teknik të projektit; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; si dhe do t’i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Komisioni ndërsa kompania mbikëqyrëse “PMN” SH.P.K merr përgjegjësin për realizimin e punëve të këtij projekti.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Prokurimi.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- “PMN” SH.P.K kompani mbikëqyrëse,
- Drejtoria për Shërbime Publike,
- Prokurimi,
- “Lani-AL” SH.P.K, operator
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-724/2022	Data: Datum: 03.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 61 paragrafi 61.27, 61.28, 61.29, 61.30 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën 12 Nr.82/2022 të datës 03.10.2022 të parashtruar nga Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe kërkesa e datës 29.09.2022 të parashtruar nga organi mbikëqyrës “P.M.N” SH.P.K, për ndërprerjen e kontratës për mos përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontrata për projektin: “Ndërtimi i Qendrës rinore në fshatin Uçë”, nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 12 Nr.82/2022 e datës 03.10.2022 e parashtruar nga Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe kërkesa e datës 29.09.2022, e parashtruar nga organi mbikëqyrës “P.M.N” SH.P.K., për ndërprerjen e kontratës për mos përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontratat për projektin: “Ndërtimi i Qendrës rinore në fshatin Uçë”, me numër të jashtë prokurimi 623-22-3836/5-2-1, kontrata e nënshkruar me 10.06.2022 të cilën e ka fituar për ta realizuar operatori “DETARI” SH.P.K.
- 2.** Obligohet Menaxheri i Prokurimit ti ndërmerr të gjitha masat e nevojshme bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit të Prokurimit për ndërprerjen e kontratave si në piken 1 të këtij vendimi.
- 3.** Obligohet Menaxheri i Prokurimit që Vendimin për ndërprerjen e kësaj kontrate të dërgoj në Organin Mbikëqyrës të Prokurimit OSHP.
- 4.** Ky vendim bëhet i plotfuqishëm menjëherë pas nënshkrimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe obligohet: Menaxheri i Prokurimit të zbatoj.

A r s y e t i m

Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, ka parashtruar kërkesën 12 Nr.82/2022 të datës 03.10.2022 si dhe organi mbikëqyrës “P.M.N” SH.P.K ka parashtruar kërkesën e datës 29.09.2022 për ndërprerjen e kontratës për mos përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontrata për projektin: “Ndërtimi i Qendrës rinore në fshatin Uçë”, me numër të jashtë prokurimi 623-22-3836/5-2-1 e nënshkruar kontrata me 10.06.2022 të cilin e ka fituar për ta realizuar operatori “DETARI” SH.P.K. Pas shqyrtimit të kërkesës ZKA-ja miraton kërkesën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe kërkesën e organi mbikëqyrës “P.M.N” SH.P.K. e që e obligon Menaxherin e Prokurimit që ti ndërmarr të gjitha masat e nevojshme sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Gëzim Ademaj-Udhëheqës i Prokurimit,
- Organit Mbikëqyrës të Prokurimit-OSHP-së,
- Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport
- “PMN” SH.P.K, organi mbikëqyrës i kontratës dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës-ZKA
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-725/022	Data: Datum: 03.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, në nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoj kërkesën 01Nr.400-41461 të datës 27.09.2022 te parashtruar nga Esat Loshaj nga Komuna e Pejës për përkrahje financiare për botimin e librit “Dokumentar-fakto grafik” dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 01 Nr.400-41461 e datës 27.09.2022, e parashtruar nga Esat Loshaj, për përkrahje financiare për botimin e librit “Dokumentar-fakto grafik” dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **400.00€ (katërqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës Kryetarit.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Esat Loshaj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra e Kryetarit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Esat Loshaj, ka parashtruar kërkesën 01Nr.400-41461 të datës 27.09.2022, për përkrahje financiare për botimin e librit “Dokumentar-fakto grafik”

Kryetari shqyrtoi kërkesën e Esat Loshaj dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Esat Loshaj ka kërkuar mjete financiare në shumë prej **4,200.00€**, por në mungesë të mjeteve financiare përkrahet financiarisht në shumë prej **400.00€** për shkak të rëndësisë së botimit të librit dokumentar.

Në plan programin buxhetor Zyrës Kryetarit është i përcaktuar pozicioni i subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Esat Loshaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi..

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Esat Loshaj,
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.726/2022	Data: Datum: 04.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 22 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) dhe nenit 19 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj lajmërimin 02 Nr.208/2022 të datës 03.10.2022 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për pagesën e një page mujore me përfundimin e shërbimit-pensionimit e Rukmane Gashi, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Zyrtare për Biblioteka4, nxjerr:

V E N D I M

1. **KOMPENZOHET: znj.Rukmane Gashi**, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Zyrtare për Biblioteka 4, në Qendrës Kulturore “Adem Jashari” në Istog, në lartësi prej një page mujore të cilën e ka realizuar deri në pensionim.
2. Nëpunësit civil të lartpërmendurës i përfundon shërbimi me **23.10.2022**.
3. Pagesa e mjeteve të cekura në pikën 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Zyrtari Financiar-përgjegjës për Paga, Mëditje dhe Kompensime obligohet që Rukmane Gashit, t'ia bëjë pagesën e një page mujore të realizuar, sipas procedurave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset, Zyrtari Financiar-përgjegjës për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe Menaxheri i Personelit.
6. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Rukmane Gashi,
- Menaxheri i Personelit,
- Zyrtari Financiar-përgjegjës për Paga, Mëditje dhe Kompensime,
- Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-727/2022	Data: Datum: 04.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për Shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08 Nr.120-41631 të datës 28.09.2022 të parashtruar nga Abedin Rexhaj nga Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Bajram Rexhaj dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 08 Nr.120-41631 e datës 28.09.2022, e parashtruar nga Abedin Rexhaj, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Bajram Rexhaj dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 13490-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike kodi i programit buxhetor 18017.
- 2.** Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Abedin Rexhaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- 3.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
- 4.** Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Abedin Rexhaj,,
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z. Ilir FERAFI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-728/2022	Data: Datum: 04.10.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 8 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62 i miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.208/2022 të datës 15.09.2022 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për kompensim të dy eksperteve të jashtëm të komisionit vlerësues për projektet e OJQ-ve, për organizimin e aktivitetit “Dita e Mollës” dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa 09 Nr.208/2022 e datës 15.09.2022 e parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për pagesën e dy ekspertëve të jashtëm të komisionit vlerësues për projektet e OJQ-ve, për organizimin e aktivitetit “Dita e Mollës” dhe ndahen mjete buxhetore në shumë prej **160,00€(njëqind e gjashtëdhjetë euro)**.
- Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga **80€ (tetëdhjetë euro)** në xhirollogarinë e **Ermir Çitakut**, dhe **80€ (tetëdhjetë euro)** në xhirollogarinë e **Armend Gashit** nga kodi ekonomik 47017 i programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi,
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
- Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ermir Çitakut,
- Armend Gashit
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI





 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-729/2022	Data: Datum: 05.10.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 04.10.2022, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i kanalit të ujitjes Osmanaj në Drejë 5000m-faza e parë”, Lot2 “Ndërtimi i kanalit të ujitjes të tregut të Qytetit”, Lot4 “Ndërtimi i kanalit të ujitjes të jazi i madh në Istog të Poshtëm”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-10039-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-073-521, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i kanalit të ujitjes Osmanaj në Drejë 5000m-faza e parë”, Lot2 “Ndërtimi i kanalit të ujitjes të tregut të Qytetit”, Lot4 “Ndërtimi i kanalit të ujitjes te jazi i madh në Istog të Poshtëm”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-10039-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-073-52, dhe në komision caktohen

- 1.1. Fadil Kabashi,** Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. Shefqet Imeraj,** Zyrtar i Prokurimit 2, anëtar dhe
- 1.3. Dardan Blakaj,** Zyrtar për subvencione, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kritaret e specifikuar në dosjen e tenderit: Lot1 “Ndërtimi i kanalit të ujitjes Osmanaj në Drejë 5000m faza e parë”, Lot2 “Ndërtimi i kanalit të ujitjes të tregut të Qytetit”, Lot4 “Ndërtimi i kanalit të ujitjes te jazi i madh në Istog të Poshtëm”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
z.Bir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 732/2022	Data: Datum: 05.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-40523, të datës 16.09.2022, të parashtruar nga z.Armend Hajzeraj, nga fsh.Suhogerllë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e prindit (Sherif Hajzeraj) në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-40523, të datës 16.09.2022, e parashtruar nga z.Armend Hajzeraj, për përkrahje me karburant për dërgimin e prindit të tij në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore, (Radioterapisë) dhe i lejohen 200 litra karburant.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë z.Armend Hajzeraj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Armend Hajzeraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-40523, të datës 16.09.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i prindit Sherif Hajzeraj.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se z. Sherif Hajzeraj, është i sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për në Prishtinë për marrjen e terapisë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Armend Hajzeraj, Drejtoria për Shëndetësi, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udh. sektorit ligjor
 Zekije Sutaj

Kryetari i Komunës
 Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-733/2022	Data: Datum: 06.10.2022	

Kryetari-i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 04.10.2022, shqyrtoj kërkesën e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi 09 Nr.228/2022 të datës 06.10.2022 për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: Lot3 “Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Baicë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-10039-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-073-521, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: Lot3 “Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Baicë”; me numër të jashtëm prokurimi 633-022-10039-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-22-073-52, dhe në komision caktohen

- 1.1. Shefqet Imeraj,** Zyrtar i Prokurimit 2, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. Dardan Blakaj,** Zyrtar për subvencion, anëtar dhe
- 1.3. Gentrita Salihaj,** Zyrtare për subvencione, anëtare.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: Lot3 “Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Baicë”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-734/2022	Data: Datum: 06.10.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 04.10.2022, të pranuar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim të datës 06.10.2022, për themelim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin: Lot5 “Ndërtimi i rrugëve lokale në Kaliqan-Ukaj dhe Metaj”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-5907-5-2-1/C-566, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punëve për projektin: Lot5 “Ndërtimi i rrugëve lokale në Kaliqan-Ukaj dhe Metaj”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-5907-5-2-1/C-566 cilin projekt e ka realizuar operatori “**GRANITI**” SH.P.K dhe në komision caktohen:

- 1.1. Besnik Metaj,** Zyrtar i Lartëi Tatimit në Pronë, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Ardon Arifaj,** Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave, anëtar dhe
- 1.3. Migjen Maxharri,** Zyrtar për Promovim të Turizmit, anëtar.

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi; sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj kompaninë mbikëqyrëse “PMN” SH.P.K; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e pranimit teknik të projektit; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; si dhe do t’i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Komisioni ndërsa kompania mbikëqyrëse “PMN” SH.P.K men përgjegjësin për realizimin e punëve të këtij projekti.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Prokurimi.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- “PMN” SH.P.K kompani mbikëqyrëse,
- Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim,
- Prokurimi,
- “GRANITI” SH.P.K operator
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI






Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Istogut

Opstine Istok
Municipality of Istog

Nr. 735/2022
Datë: 06.10.2022

Kryetari i Komunës së Istogut, z.Illir Ferati bazuar në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe në mbështetje të zbatimit të veprimit 3.2 të Planit të Veprimit 2022-2024 të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nr. 27.29 të datës, 06.10.2022, nxjerr:

V E N D I M

1. Zyrtar përgjegjës për procesin e barrës administrative në kuadër të Komunës së Istogut, caktohet: Kushtrim Gecaj, zyrtarë për shërbim me qytetarë, në Drejtorinë e Administratës.
2. Përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës për procesin e barrës administrative, janë:
 - 2.1. Koordinimi i procesit të barrës administrative brenda Komunës;
 - 2.2. Komunikimi, përfaqësimi dhe koordinimi me Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për mbarëvajtjen e procesit të barrës administrative, në kuadër të komunës;
 - 2.3. Pjesëmarrja dhe kontrollimi i politikave publike të zhvilluara nga Komuna, në kontekst të procesit të barrës administrative;
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ilir FERATI

Kryetar i Komunës së Istogut



Vendimi iu dërgohet:

1. Z. Kushtrim Gecaj
2. Zv. Sekretares së MAPL
3. Zyrës për Planifikim Strategjik/ZKM
4. Arkivit



Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Istogut

Opstine Istok
Municipality of Istog

Nr. 736/2022

Datë: 06.10.2022

Kryetari i Komunës së Istogut, z.Illir Ferati bazuar në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe në mbështetje të zbatimit të veprimit 3.2 të Planit të Veprimit 2022-2024 të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nr. 27.29 të datës, 14.09.2022, nxjerr:

V E N D I M

1. Zyrtar përgjegjës për procesin e barrës administrative në kuadër të Komunës së Istogut, caktohet: Faton Bytyqi, IT në Drejtorinë e Administratës.
2. Përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës për procesin e barrës administrative, janë:
 - 2.1. Koordinimi i procesit të barrës administrative brenda Komunës;
 - 2.2. Komunikimi, përfaqësimi dhe koordinimi me Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për mbarëvajtjen e procesit të barrës administrative, në kuadër të komunës;
 - 2.3. Pjesëmarrja dhe kontrollimi i politikave publike të zhvilluara nga Komuna, në kontekst të procesit të barrës administrative;
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ilir FERATI

Kryetar i Komunës së Istogut



Vendimi iu dërgohet:

1. Z. Faton Bytyqi
2. Zv. Sekretares së MAPL
3. Zyrës për Planifikim Strategjik/ZKM
4. Arkivit

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-738/022	Data: Datum: 07.10.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën, 06 Nr.553-26563 të datës 30.06.2022, të parashtruar nga znj.Shahe Gashaj, nga fsh.Serbobranë, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-26563, e datës 30.06.2022 e parashtruar nga znj.Shahe Gashaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e znj.Shahe Gashaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

znj.Shahe Gashaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-26563, të datës 30.06.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.
Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.
Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se znj.Shahe Gashaj është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaft të kushtueshme.
E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)**.
Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.
Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.


Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

